



BANKA QENDRORE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS
CENTRALNA BANKA REPUBLIKE KOSOVA
CENTRAL BANK OF THE REPUBLIC OF KOSOVO

Analizë mbi përdorimin e Debitimit Direkt

Q e r s h o r 2 0 1 6

BANKA QENDRORE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS
CENTRALNA BANKA REPUBLIKE KOSOVA
CENTRAL BANK OF THE REPUBLIC OF KOSOVO

Analizë mbi përdorimin e Debitimit Direkt

BOTUES ©Banka Qendrore e Republikës së Kosovës
Departamenti i Sistemit të Pagesave
33 Garibaldi, Prishtinë 10000
Tel: ++381 38 222 055
Fax: ++381 38 243 763

FAQJA E INTERNETIT www.bqk-kos.org

ADRESA ELEKTRONIKE payment.systems@bqk-kos.org

Gjylfidane Kastrati-Kadrijaj, Drejtore e Departamentit të
Sistemit të Pagesave
Masar Baxhaku, Analist për Mbikëqyrje të Sistemit të Pagesave
Qëndresa Krasniqi, Zyrtare për Mbikëqyrje të Sistemit të
Pagesave

HYRJE

Një sistem i sigurt dhe efektiv i pagesave është i domosdoshëm për funksionimin e mirëfilltë të sistemit financiar në vend. BQK-ja ka vazhduar aktivitetin e saj për të promovuar një sistem të sigurt, të qëndrueshëm dhe efikas të pagesave me qëllim ruajtjen e stabilitetit financiar në vend dhe evitimin e rreziqeve të mundshme, që mund t'i kanosen sistemit të pagesave.

Departamenti i Sistemit të Pagesave (DSP) i BQK-së në vazhden e plotësimit të objektivave sipas Strategjisë për Zhvillimin e Sistemit Kombëtar të Pagesave, në vitin 2009 ka dizajnuar dhe funksionalizuar skemën më të re për pagesa, Debitimin Direkt. Skema e Debitimit Direkt është metodë e volitshme, e sigurt dhe e përshtatshme për pagesa të rregullta dhe periodike të kategorive të shërbimeve të ndryshme. Është një instrument që mundëson kryerjen e pagesave drejtpërdrejt nga llogaria bankare e debitorit, nga ku kërkesa për tërheqje të fondeve iniciohet nga kreditori përmes bankës së tij bazuar në autorizimin, që debitori i jep kreditorit dhe vetëm nëse ai ka qenë paraprakisht i njoftuar për shumën dhe datën e pagesës.

Në këtë dokument janë analizuar zhvillimet e kësaj skeme të pagesave. Janë pasqyruar faktorët që kanë ndikuar në rritjen e përdorimit të saj, si dhe sfidat me të cilat mund të ballafaqohet në të ardhmen kjo skemë e pagesave. Është analizuar numri dhe vlera e transaksioneve të realizuara përmes skemës së Debitimit Direkt, duke paraqitur dhe analizuar të dhëna statistikore, që nga viti 2009 deri në vitin 2015.

DSP-ja edhe në të ardhmen në bashkëpunim me banka dhe kompani të ndryshme do të vazhdojë promovimin e pagesave përmes kësaj skeme, pasi që kjo është një formë plotësisht e automatizuar dhe shumë efektive për kryerje të pagesave të caktuara periodike. Debitimi Direkt në vendet e zhvilluara është pjesë shumë e rëndësishme e sistemeve të pagesave, ndërsa në vendin tonë përdoret nga një numër mjaft i vogël i qytetarëve, por inkurajues është fakti se përdorimi i tij vazhdon të rritet.

Debitimi Direkt

Skema e Debitimit Direkt i lejon kreditorit (faturuesit) të mbledhë fonde nga llogaria e debitorit (paguesit), me kusht që një autorizim i nënshkruar të jetë dhënë nga paguesi për faturuesin. Autorizimi nënshkruhet nga paguesi me të cilin autorizon kredituesin (faturuesin) për të realizuar një pagesë, dhe për të udhëzuar bankën e debitorit (paguesit) për të kryer atë pagesë. Autorizimet të cilat duhet t'i plotësojnë debitorët (paguesit) ofrohen nga ana e vet kreditorëve (faturuesve).

Funksionimi i skemës së Debitimit Direkt është i rregulluar me “Rregulloren për Skemën e Debitimit Direkt të Sistemit Elektronik të Kliringut Ndërbankar”. Qëllimi i Rregullores mbi Skemën e Debitimit Direkt të Sistemit Elektronik të Kliringut Ndërbankar është të përcaktojë parimet dhe kërkesat bazë në lidhje me funksionimin e kësaj skeme.

Pagesat përmes Debitimit Direkt përfaqësojnë një lloj të veçantë të transaksioneve të destinuara për pagesat e standardizuara dhe të automatizuara të institucioneve faturuese, me ç'rast rritet efikasiteti si për kompanitë faturuese, ashtu edhe për klientët e tyre. Qëllimi i Debitimit Direkt është ofrimi i një sistemi të automatizuar të pagesave, duke eliminuar pagesat me para të gatshme dhe duke zhvilluar pagesat përmes llogarive bankare.


Skema e funksionimit të Debitimit Direkt

Në figurën 1 është paraqitur skema e funksionimit të pagesave përmes Debitimit Direkt. Së pari, klienti që dëshiron të kryejë pagesat periodike përmes kësaj skeme duhet të nënshkruajë autorizimin për kompaninë të cilës duhet t'i bëhen pagesat. Kompania e cila autorizohet nga klienti për të realizuar pagesa me Debitim Direkt, duhet ta bëjë regjistrimin e autorizimit me bankën e vet. Banka e kompanisë duhet ta bëjë regjistrimin e autorizimit me bankën e klientit përmes Sistemit Elektronik të Kliringut Ndërbankar. Çdo muaj përsëriten hapat në vijim:

- Për çdo periudhë (p.sh. muaj), kompania do të njoftojë klientin paraprakisht për shumën dhe datën e ekzekutimit të pagesës përkatëse;
- Kompania do të dërgojë të dhënat elektronike për Debitim Direkt te banka e vet;

- Banka e kompanisë bën verifikimin dhe përpunimin e të dhënave dhe i dërgon ato te banka e klientit në formë të kërkesës për Debitim Direkt përmes Sistemit Elektronik të Kliringut Ndërbankar;
- Banka e klientit bën verifikimin e të dhënave dhe e debiton llogarinë e klientit dhe shumën përkatëse e dërgon te banka e kompanisë përmes Sistemit Elektronik të Kliringut Ndërbankar;
- Banka e kompanisë e krediton llogarinë e kompanisë për shumën e pranuar;

Figura 1. Funkionimi i Skemës së Debitimit Direkt



Roli i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës (BQK) si pronare dhe operatore e Sistemit Elektronik të Kliringut Ndërbankar, administron dhe mbikëqyr skemën e Debitimit Direkt. BQK-ja përcakton rregullat operacionale dhe teknike si dhe përgjegjësitë dhe të drejtat e pjesëmarrësve në skemën e Debitimit Direkt. BQK-ja po ashtu autorizon dhe regjistron kompanitë pjesëmarrëse dhe mirëmban bazën përkatëse të të dhënave.

Pjesëmarrësit në transaksionet përmes Debitimit Direkt

1. Iniciuesi/Kreditori – është kompania për shërbimet e të cilës kryhet pagesa në këtë skemë;

2. Klienti/Debitori – klienti i cili kryen pagesat për shërbimet e ofruara nga kreditori;
3. Banka e iniciuesit/kreditortit – është banka ku kreditori mban llogarinë bankare;
4. Banka e paguesit/Debitorit – është banka ku debitori mbanë llogarinë e tij bankare;
5. Banka Qendrore e Republikës së Kosovës – si pronare dhe operatore e SEKN-së kontrollon funksionimin e skemës së Debitimit Direkt. Njëherësh BQK-ja mund të marrë pjesë në skemën e Debitimit Direkt edhe në cilësitë e palëve të tjera pjesëmarrëse.

Përfitimet nga Debitimi Direkt

Përfitimet e klientëve nga Debitimi Direkt:

- Debitimi Direkt mund t’iu kursej para - Debitimi Direkt konsiderohet shumë i përshtatshëm si nga bizneset ashtu edhe nga klientët. Për këtë arsye disa kompani ofrojnë zbritje gjatë pagesave përmes debitimit direkt.
- Saktësi në kryerje të pagesave- Debitimi Direkt është një nga mënyrat më të sigurta dhe më efikase për të paguar faturat.
- Debitimi Direkt paraqet një mjet të përshtatshëm dhe të sigurt për të paguar faturat;
- Pagesat kryhen automatikisht, kështu që faturat nuk do të harrohen, nuk do të humbin dhe nuk ka rrezik për pagesa të vonuara;
- Debitimi Direkt ofron lehtësi për konsumatorët në mënyrë që ata të mos merren me pasojat e pagesave të vonuara; Debitimi Direkt po ashtu u mundëson konsumatorëve të dinë kur saktësisht llogaria e tyre do të debitohet;
- Klienti nuk paguan asnjë tarifë për shërbimin që përfiton nga shfrytëzimi i Debitimit Direkt;
- Debitimi Direkt ju kursen kohë- Jeta bashkëkohore është shumë intensive, prandaj koha paraqet faktor shumë të rëndësishëm. Debitimi Direkt ju zgjidh problemet për pagesën e faturave duke ju shmangur nga pritja në radhë për pagesa të faturave. Klienti do ta ketë më të lehtë për të menaxhuar faturat e tij dhe për të llogaritur se sa do të paguajë çdo muaj.

Rëndësia e Debitimit Direkt për kreditorin (faturuesin)

Debitimi Direkt ju ndihmon për të përmirësuar qarkullimin e mjeteve monetare dhe menaxhimin e thesarit. Kjo është veçanërisht e dobishme nëse ju do të mblidhni të hyra rregullisht nga klientët brenda vendit, dhe do të dëshironit automatizim të procesimit të pagesave dhe rekonsilim më të lehtë të pagesave pas pranimit.

Në cilat raste nuk është e përshtatshme pagesa përmes Debitimit Direkt?

- Për pagesat të cilat kërkojnë klirim të menjëhershëm - Debitimi Direkt nuk është pagesë që kryhet menjëherë, kërkon një kohë të caktuar.
- Për pagesa me vlera të mëdha dhe mjete likuide – Debitimi Direkt nuk është i përshtatshëm për pagesa gjatë blerjes së veturave apo në rastet e këmbimeve valutore.

Zhvillimi i Skemës së Debitimit Direkt

Funksionimi i sigurt dhe efikas i Sistemit Elektronik të Kliringut Ndërbankar (SEKN) ka rezultuar me rritje të numrit dhe vlerës së transaksioneve të procesuara përmes këtij sistemi. Njëkohësisht edhe numri dhe vlera e pagesave të skemës së Debitimit Direkt kanë shënuar rritje, bashkë me rritjen e kompanive që përdorin këtë skemë.

Tabela 1. Numri dhe vlera e transaksioneve Debitim Direkt ndërbankare

Vitet	Numri	Vlera (euro)
2009	201	3,202.41
2010	3,303	2,807,939.49
2011	7,321	6,252,067.54
2012	10,304	8,043,429.25
2013	13,115	6,763,903.32
2014	14,582	7,182,930.92
2015	15,565	7,152,037.05

Burimi: BQK (2016)

Në tabelën 1 është paraqitur numri dhe vlera e transaksioneve ndërbankare të realizuara përmes skemës së Debitimit Direkt. Nga të dhënat e paraqitura në tabelë mund të konstatohet për rritjen e vazhdueshme të numrit të transaksioneve të skemës së Debitimit Direkt.

Skema e pagesave të Debitimit Direkt është funksionalizuar në vitin 2009, prandaj edhe në këtë vit ka pasur numër dhe vlerë të vogël të këtyre transaksioneve. Me kalimin e kohës është rritur numri i kompanive pjesëmarrëse në skemë, po ashtu edhe numri i klientëve që përdorin skemën e Debitimit Direkt.

Pra, në vitin 2009 numri i transaksioneve përmes Debitimit Direkt ishte 201 transaksione, ndërsa vlera 3,202 Euro, kjo pasi që skema është funksionalizuar në muajt e fundit të këtij viti andaj edhe kishte numër të vogël të transaksioneve. Në vitin 2011, numri dhe vlera e transaksioneve është dyfishuar krahasuar me një vit më parë, si rezultat i angazhimit të të gjithë pjesëmarrësve në skemë. Në vitin 2012 numri i transaksioneve u rrit për rreth 40.7%, ndërsa vlera e transaksioneve u rrit për rreth 28.7%.

Në vitin 2013 numri i transaksioneve të DD u rrit për 27.3 përqind, ndërsa vlera e tyre pati rënie prej 15.9 përqind. Në vitin 2015 numri i transaksioneve përmes skemës së Debitimit Direkt u rrit për 6.7 përqind, ndërsa vlera e tyre pati rënie të lehtë prej rreth 0.4 përqind.

Tabela 2. Numri dhe vlera e transaksioneve të Debitimit Direkt brenda bankës

Vitet	Numri	Vlera (euro)
2009	3,769	139,236.25
2010	18,994	2,013,925.55
2011	24,203	1,200,015.61
2012	38,811	1,783,312.23
2013	34,156	1,845,449.37
2014	35,409	2,076,851.39
2015	27,298	1,726,504.04

Burimi: Bankat komerciale

Përpos formës së Debitimit Direkt ndërbankar, bankat komerciale po ashtu kanë zhvilluar edhe debitimin direkt brenda bankës ku edhe debitori edhe kreditori janë klient të së njëjtës bankë. Në tabelën 2 janë paraqitur të dhënat për numrin dhe vlerën e pagesave brenda bankës përmes Debitimit Direkt. Nga të dhënat e paraqitura në tabelën 2 shihet se gjatë vitit 2015 numri dhe vlera e pagesave përmes debitimit direkt brenda bankave ka pasur rënie prej 22.9 përqind, respektivisht 16.9 përqind.

Përfundim

Sipas analizës së mësipërme mund të konstatohet se pagesat përmes Debitimit Direkt kanë filluar të shtohen, si rezultat i rritjes së numrit të kompanive pjesëmarrëse në këtë skemë, si dhe rritja e numrit të përdoruesve nga ana e kompanive të cilat deri tani kanë qenë pjesë e kësaj skeme.

Edhe më tutje pjesëmarrës kryesor i kësaj skeme vazhdon të mbetet KEDS (ish KEK-sh.a.) i cili dominon si në numër ashtu edhe në vlerë të transaksioneve. Po ashtu edhe kompanitë e tjera publike, si dhe një numër i caktuar i kompanive private, janë duke rritur numrin dhe vlerën e transaksioneve përmes kësaj skeme.

Edhe pse me trend rritës, Debitimi Direkt vazhdon të mbetet pak i përdorur nga ana e qytetarëve në Kosovë. Duke u krahasuar me vendet e të cilat Debitimin Direkt e kanë njërin nga instrumentet më të rëndësishme për pagesa periodike, atëherë edhe institucionet financiare dhe kompanitë e tjera në vend mund të rritin përdorimin e kësaj skeme përmes promovimit dhe mekanizmave të tjerë inkurajues.

BQK-ja është treguar e gatshme që të ndihmojë qoftë kompanitë pjesëmarrëse ashtu edhe kompanitë e tjera si pjesëmarrës potencial, me qëllim rritjen e përdorimit të Debitimit Direkt. Përmes diskutimeve me këto kompani është synuar shpjegimi i përfitimeve, që kanë ata nga pjesëmarrja në këtë skemë, duke theksuar veçanërisht rritjen e efikasitetit dhe shpenzimet e ulëta në mbledhjen e të hyrave.

Me qëllim që skema të jetë sa më e përshtatshme si për kompanitë përfituese, ashtu edhe për klientë, BQK-ja në bashkëpunim të ngushtë me kompanitë ka aplikuar disa ndryshime në skemë duke mundësuar nënshkrimin e autorizimit për Debitim Direkt edhe në bankën e pagesit (klientit) njëjtë sikurse në kompaninë përfituese, për të cilat besohet se do të rritin përdorimin e saj në të ardhmen.